



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 217 Prot.

Tiranë, më 07. 02. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 39, Datë 07. 02. 2018**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 153, datë 15.11.2017, e bërë nga L. A., kundër Shoqërisë “Center Shqiptare sh.p.k.”, Berat, në të cilën pretendon diskriminim *për shkak gjendjes shëndetësore dhe lidhjeve familjare*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

L. A. ka qënë punonjëse pranë Shoqërisë “Center Shqiptare sh.p.k.”, Berat. Për shkak të gjendjes shëndetësore të saj dhe të djalit, ka qënë e detyruar të mungojë në punë pa të drejtë page për disa kohë. Pasi gjendja e saj shëndetësore është përmirësuar, është paraqitur pranë punëdhënësit, por nuk është lejuar të punojë me pretendimin se kishte mungesa të herë pas hershme dhe për këtë arsye i kishin ndërprerë marrëdhëniet e punës. Pak kohë pasi është pushuar, punëdhënësi i ka dërguar në shtëpi librezën e punës me shënimin “*largohet me dëshirë nga puna*”. Në këto kushte, është drejtuar pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Berat për tu rregjistruar si punëkërkuese e papunë dhe për të përfituar më pas ndihmë ekonomike. Nga ana e përfaqësuesve të kësaj zyre, është bërë me dije se mund të rregjistrohet si punëkërkuese e papunë, por nuk mund të përfitojë ndihmë ekonomike nëse largohet me dëshirë nga puna.

Pësa më lart, ankuesja kërkon që Shoqëria “Center Shqiptare sh.p.k.”, Berat, të korrigjojë shënimin në librezën e punës dhe të shënojë në të që largimi nga puna është bërë për shkak të gjendjes së saj shëndetësore.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesi nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit informacion të mjaftueshëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e Shoqërisë “Center Shqiptare sh.p.k.”, Berat.

Në këto kushte, Komisioneri iu drejtua ankueses me anë të shkresës nr. 1128/1 prot., datë 14.12.2017, ku për efekt të shqyrtimit të ankesës së depozituar nga ana e saj, i kërkohej informacion nëse ka kërkuar ndonjëherë nga punëdhënësi të bëhej korrigjimi në librezën e saj të punës.

Për sa më sipër, ankuesja është vënë në dijeni<sup>1</sup> të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 1128/1 prot., më datë 16.12.2017. Pas marrjes dijeni, ankuesja nuk dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 153, datë 15.11.2017, Komisioneri konstatoi se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* përcaktohet një listë joshtruese shkaqesh diskriminimi, ku në çdo rast pala ankuese duhet të japë argumentimet përkatëse, të cilat të krijojnë një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pabarabartë dhe disfavorizues, që ajo pretendon se është ndërmarrë ndaj vajzës së saj, me këtë shkak diskriminimi.

Në këto kushte, në mungesë të provave të kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë informacion nëse ka kërkuar ndonjëherë nga punëdhënësi të bëhej korrigjimi në librezën e saj të punës, nuk është e mundur që të iniciohet procesi i hetimit administrativ.

Për sa më sipër, nga pikëpamja formale, Komisioneri vlerësoi se ankesa nr. 153, datë 15.11.2017, e L. A. nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), parashikohet se :

*“Ankesa nuk pranohet nëse:*

*a).....*

*b).....*

*c).....*

*ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;*

Për sa më sipër, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 153, datë 15.11.2017, e L. A., Komisioneri gjykoi se për rastin konkret nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

---

<sup>1</sup> Referuar Lajmërim-Marrjes së Postës Shqiptare dt. 16.12.2017

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 153, datë 15.11.2017, e L. A., pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**KOMISIONERI**

---

**Irma BARAKU**

(Shkaku: gjendja shëndetësore dhe lidhjet familjare)

(Fusha: Shërbime)